

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7131
E shtunë, 2 mars 2024
Çmimi 0.50 €

**Komandanti Walker:
Paqeruajtësit amerikanë
të gatshëm ta parandabjnë
dhunën në veri** | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KONJUFCA: BE-ja S'KA KOMPETENCË T'I PROPOZOJË KOSOVËS DRAFT-STATUT PËR ASOCIACIONIN

 | FAQE 4-5

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë të premten se Bashkimi Evropian (BE) nuk ka kompetencë t'i propozojë Kosovës një draft-statut për formimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe. "Nuk mendoj se

është kompetencë e BE-së t'i propozojë draft Kosovës dhe Kosova të qëndrojë gatitu dhe ta dërgojë draftin që BE-ja e propozon. Nuk pajtohem me këtë procedurë", ka thënë Konjufca. Një ditë më parë ambasadori amerikan në Kosovë,

Jeff Hovenier, ka treguar se e ka këshilluar Qeverinë e Kosovës ta kërkojë sa më shpejt mendimin e Gjykatës Kushtetuese për një draft-statut të hartuar vitin e kaluar prej Perëndimit për themelimin e Asociacionit

AKTUALE



**PENDAROVSKI KËRKON EDHE NJË
MANDAT PRESIDENCIAL** | F. 2

**PDK-ja: QEVERIA KURTI KA
DËSHTUAR NË GARANTIMIN
E SIGURISË KOMBËTARE** | F. 7

**KQZ-ja JAVËN TJETËR DISKUTON
PËR VERIFIKIMIN E NËNSHKRIMEVE
PËR SHKARKIM TË KRYETARËVE
NË VERI** | F. 3

EKONOMI



**BIZNESET NJOFTOHEN ME
PROCEDURAT E ZBATIMIT
TË NËNSHKRIMIT ELEKTRONIK** | F. 8

**MURATI TAKON CUMMINGIN, TEMË
DISKUTIMI THELLIMI I NDËRVEPRIMIT
EKONOMIK KOSOVË - BRITANI** | F. 8

SPORT



**NDESHJE INTERESANTE NË ELITËN
E BASKETBOLLIT** | F. 10

**SHQIPËRIA
PRANON
DRONËT
BAYRAKTAR,
DËRGOHEN
NË BAZËN E
NATO-s NË
KUÇOVË** | F. 7



ALEKSEI NAVALNY VARROSET NË MOSKË | F. 6



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pendarovski kërkon edhe një mandat presidencial

SHKUP, 1 MARS - Presidenti aktual i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, të premten shpalli kandidaturën për zgjedhjet presidenciale që do të mbahen më 24 prill. Pendarovski tha se kandidaturën e shpalli pas mbështetjes publike që ka marrë nga qytetarë të shumtë dhe personalitete të ndryshme për t'u nominuar edhe për një mandat në krye të shtetit. Kandidatura e tij do ta ketë mbështetjen edhe të Lidhjes Social Demokrate (LSDM) në pushtet, e cila edhe e kishte zgjedhur si kandidat për president para pesë vjetësh. "Arsyeja e parë e kandidimit është se po e përfundoj mandatin e presidentit pa asnjë aferë korruptive, pa asnjë gabim strategjik, asnjë rast të nepotizmit lidhur me familjen apo bashkëpunëtorët e mi", tha

Pendarovski. "Isha koordinator nacional për NATO-n dhe gjatë mandatit tim të parë u bëmë anëtare e Aleancës Veriatlantike. Gjatë mandatit të dytë pres që të bëhemi shtet anëtar i Bashkimit Evropian", u shpreh ai.

Marrëdhëniet ndëretnike, sipas Pendarovskit, mbeten shtylla e kohezionit dhe e stabilitetit të brendshëm, andaj edhe kërkoj mbështetjen e të gjitha bashkësive etnike në zgjedhjet presidenciale.

"Unë jam maqedonas, por në këto pesë vjet të mandatit tim nuk ka pasur asnjë rast të vetëm që përkatësia ime etnike të ketë qenë arsyeje që dikë ta favorizoj apo degradoj", theksoi Pendarovski.

Duke komentuar kërkesën e partive shqiptare që presidenti në të ardhmen të zgjedhet nga Kuvendi, Pendarovski tha se



është kundër një kërkesë të tillë, pasi zgjedhja e presidentit në Kuvend nuk do t'i jepte kreut të shtetit fuqinë që merr nga populli përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. "Unë gjatë mandatit tim kam refuzuar disa kërkesa të partive politike dhe

jam i bindur se sikur të isha zgjedhur në Kuvend, po atë ditë do të shkarkohesha nga pozita e presidentit", tha Pendarovski. Përveç Pendarovskit, kandidaturat për zgjedhjet presidenciale i kanë shpallur edhe tetë kandidatë të tjerë, por

prej tyre deri tani 10 mijë nënshkrimet e nevojshme për të marrë pjesë në garën zgjedhore i kanë grumbulluar Bujar Osmani, kandidat i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Arben Taravari, kandidat i opozitës së bashkuar shqiptare, Biljana Vankovska nga partia E Maja dhe Maksim Dimitrievski nga Partia ZNAM (Për Maqedoninë tonë).

VMRO DPMNE-ja, në opozitë, kandidaturën e Biljana Siljanovska-Davkovës do të shpallë të shtunën, më 2 mars. Afati i paraqitjes së kandidaturave për zgjedhjet presidenciale skadon më 8 mars. Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut do të mbahen në dy runde, i pari më 24 prill, ndërsa runda e dytë do të mbahet së bashku me zgjedhjet parlamentare më 8 maj.

Çfarë synoi Macroni me idenë e dërgimit të trupave perëndimore në Ukrainë?

PARIS, 1 MARS - Presidenti francez Emmanuel Macron është parë i izoluar në skenën evropiane këtë javë, pasi ka thënë se mundësia e dërgimit të trupave perëndimore në Ukrainë nuk duhet të përjashtohet, koment që ka nxitur reagime prej shumë liderëve të tjerë.

Zyrtarët francezë kanë tentuar më vonë të japin sqarime për deklaratën e Macronit, ndonëse kanë insistuar në nevojën e dërgimit të sinjaleve të qarta se Rusia nuk mund të fitojë në Ukrainë.

Kremlini ka paralajmëruar që nëse NATO-ja dërgon forca luftarake, atëherë një konflikt mes aleancës dhe Rusisë do të jetë i pashmangshëm.

Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë se një veprim i tillë mund të rrezikojë një konflikt bërthamor global.

Deklarimi i Macronit, reagimi i aleatëve

Macroni e ka përmendur mundësinë e angazhimit të ushtarëve perëndimorë për t'i ndihmuar Ukrainës teksa ka folur në një konferencë për medie pas një takimi me 20 liderë shtetesh dhe zyrtarë të tjerë të lartë në Paris.

Macroni ka thënë se nuk ekziston konsensus për t'i angazhuar trupat, mirëpo "sa i përket dinamikës, asgjë nuk mund të përjashtohet".

Nuk dihet se cili ka qenë sinjali i qartë që ka tentuar ta dërgojë Macroni, mirëpo "nuk është thënë rastësisht", ka thënë Phillips O'Brien, profesor i studimeve strategjike në Universitetin Shën Andrews në Skoci. "Mund të jetë pak paralajmërim" për Rusinë "që kjo mund të ndodhë, prandaj përgatituni", ka thënë O'Brien. Macroni ka qenë më i qartë kur ka folur për evoluimin e qëndrimeve të liderëve evropianë, prej nisjes së luftës në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022. "U rikujtoj që dy vjet më parë, shumë njerëz afër kësaj tavoline kanë thënë se do të ofrojnë helmata dhe shtretër për fjetje. Sot jemi duke thënë se na duhet të punojmë më shumë dhe më shpejt për të siguruar raketa dhe tanke".

Pas këtyre deklaratave, zyrtarë prej Gjermanisë, Polonisë dhe shteteve të tjera, që kanë marrë pjesë në takimet në Paris, kanë tentuar të distancohen prej komenteve të Macronit, duke thënë se nuk do të dërgojnë trupa në Ukrainë.

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka thënë agjencisë së lajmeve "Associated Press" se "nuk ka plane për angazhim të trupave të NATO-s" në terren.

Sqarimi francez

Ministri francez i Mbrojtjes, Sebastien Lecornu, ka thënë se



diskutimet për mundësinë e dërgimit të trupave perëndimore në Ukrainë kanë të bëjnë me mundësinë e dërgimit të njerëzve për të ndihmuar në procese të çminimit dhe operacioneve të trajnimit, larg prej vijës së frontit.

Ai ka thënë se nuk ekziston ndonjë konsensus prej këtyre diskutimeve.

Ministri i Jashtëm francez, Stephane Sejourne, ka thënë se ky lloj i pranisë ushtarake nuk do ta "kapërcente prapën luftarak".

Një diplomat francez, që ka qenë në dijeni të bisedimeve në Paris, ka thënë se synimi ka qenë të "dërgimi i një sinjali të qartë për presidentin Putin që edhe diçka e tillë ekziston si mundësi dhe nuk mund ta përjashtojë faktin që asnjë prej

partnerëve të Ukrainës nuk do të përfshihet".

Ky diplomat ka folur vetëm në kushte anonime për këtë çështje.

Ai ka thënë se Macroni "nuk e ka hedhur poshtë këtë mundësi për një arsye, siç e kemi parë, ne po bëjmë shumë gjëra që i kemi përjashtuar dy vjet më parë".

Paris ka thënë se bisedimet me shtetet aleate do të vazhdojnë në takimet e ministrave të Jashtëm dhe atyre të Mbrojtjes në ditët në vijim.

Ndryshimi i qëndrimeve të Macronit ndaj Rusisë

Pasi Rusia e ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkallë të plotë, Macroni e ka mbajtur një linjë të hapur të komunikimit me Putinin. Ai pati thënë në

qershor të vitit 2022, se presidenti rus e ka bërë një "gabim historik", mirëpo fuqitë botërore nuk duhet ta "nënçmojnë Rusinë, pasi kur luftimet të përfundojnë, ne mund të krijojmë një rrugë të re përmes mundësive diplomatike". Këto deklaratë janë kritikuar, atëbotë, prej Ukrainës dhe shumë aleatëve të Francës.

Macroni ka folur për herë të fundit me Putinin në shtator të vitit 2022, dhe qysh atëherë e ka pasur një qasje më të ashpër ndaj tij.

Komentet e tij të hënën kanë pasur për qëllim të jenë 'zile zgjimi', ka thënë François Heisbourg, analist i mbrojtjes në Institutin Ndërkombëtar për Studime Strategjike, me bazë në Londër. "Megjithatë, disa deklaratë nuk janë pritur", ka thënë Heisbourg.

Macroni ka thënë se është i shqetësuar që Rusia është duke u bërë më e ashpër në muajt e fundit. Ai e ka përmendur vdekjen e liderit opozitar rus Aleksei Navalny, shtypjen e opozitës politike ruse dhe ashpërsimin e luftimeve përgjatë vijës së frontit në Ukrainë. Qeveria e Francës ka gjetur së fundi se forcat ruse kanë kërcënuar me rrëzim të një aeroplani vëzhgues që ka patrulluar në hapësirën ajrore ndërkombëtare mbi Detin e Zi.

Osmani në Turqi për Forumin Diplomatik të Antalisë

PRISHTINË, 1 MARS - Me ftesë të presidentit të Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, presidentja Vjosa Osmani ka udhëtuar për në Turqi. Ajo do të marrë pjesë në Forumin Diplomatik të

Antalisë. Gjatë Forumit, presidentja Osmani do të jetë folëse në panelin kryesor të liderëve, me temën e forumit të sivjetmë: "Avancimi i diplomacisë në kohë trazirash".

Përgjatë punimeve të Forumit, Osmani do të takohet edhe me homologë nga disa vende të botës, pjesëmarrës të forumit. Forumi Diplomatik i Antalisë është takim i nivelit të lartë, në

të cilin adresohen sfidat ndërkombëtare dhe në të cilin marrin pjesë liderë shtetesh, diplomatë dhe akademikë. Forumi i sivjetmë do t'i zhvillojë punimet prej 1 deri më 3 mars.



Shqipëria pranon dronët Bayraktar, dërgohen në bazën e NATO-s në Kuçovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 1 MARS - Ushtria e Shqipërisë i ka pranuar tre dronë të prodhimit turk Bayraktar. Marrëveshja për blerjen e një flote me dronë të tillë është nënshkruar në dhjetor të vitit 2022. Ende nuk dihet se sa ka kushtuar blerja e njërit prej tyre. "Dronët Bayraktar, të njohur për efikasitetin dhe teknologjinë e tyre të avancuar, tashmë janë në Shqipëri! Prej dy ditësh ka filluar montimi dhe paralelisht po kryhet instalimi i infrastrukturës mbështetëse për operimin dhe kontrollin e tyre", ka shkruar ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, në "Facebook".

Ai ka thënë se zotërimi i këtyre dronëve rrit aftësinë e mbrojtjes së Shqipërisë dhe është dëshmi e angazhimit për ta garantuar sigurinë kombëtare.

Dronët Bayraktar janë vendosur në bazën e NATO-s në Kuçovë, e cila do të përurohet më 4 mars.

Dronët Bayraktar janë aeroplanë ushtarakë pa pilotë.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pati thënë se marrëveshja për dronët është arritur falë partneritetit strategjik me Turqinë. Rama e ka bërë të qartë se dronët do të përdoren edhe për misione ushtarake, por edhe policore dhe civile. "Tre dronët që do të vijnë të



parët do të jenë plotësisht të armatosur dhe të gatshëm për çdo rast dhe shpresoj që të mos ndodhë kurrë, por nuk jetojmë në kohë të sigurta. Kur siguria jonë kombëtare të jetë në kërcënim, do të jemi gati për luftë", ka thënë Rama. Marrëveshja përfshin, gjithashtu,

trajnimin e më shumë se 30 personave që do të përzgjidhen me ndihmën e kompanisë "Bayraktar" për t'u përgatitur për ta marrë funksionin e qendrës së kontrollit, që do të jetë objekt i teknologjisë më të lartë në bazën ajrore të Kuçovës.

Droni TB2 është zhvilluar në Turqi nga Selcuk Bayraktar, i diplomuar në Institutin e Teknologjisë të Masaçusetsit.

Droni Bayraktar mund të qëndrojë në qiell deri në 27 orë dhe kjo mundësohet nga një motor i thjeshtë me helikë dhe, po ashtu,

mund të fluturojë deri në 150 kilometra nga baza e tij.

Dronët TB2 janë përdorur nga Turqia në ato që ajo i quan operacione "kundër terrorizmit" kundër militantëve kurdë, por edhe në luftën civile që ende po vazhdon në Libi.

Kurti takoi mërgatën në Irlandë



Dublin, 29 shkurt - Me të filluar vizitën e tij të parë zyrtare në Irlandë, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, takoi e bashkëbisedoi me mërgatën tonë.

Ky takim i parë me diasporën tonë atje u karakterizua nga diskutime për shtetin tonë, për të tashmen dhe të ardhmen.

Kryeministri Kurti theksoi se diaspora jonë janë ambasadorët tanë më të mirë, që shpërfaqin atë se çfarë përfaqëson Kosova, vlerat unike dhe zellin e punës.

U trajtuan në hollësi programet, planet e objektivat e qeverisë të cilat synojnë kthimin e trurit dhe

bashkatdhetarëve tanë në atdhe.

"Diaspora ka kontribuar e vijon të kontribuojë për Kosovën, e ne si qeveri e kemi obligim ta vendosim mërgatën në pozicion më të volitshëm e t'i eksplorojmë format e mundësitë për bashkëpunim", tha Kurti.

Mes shumë iniciativash, kryeministri përmendi edhe Fondin Sovran.

Duke shprehur ngazëllimin e mirënjohjen e thellë për të gjithë pjesëmarrësit, për diasporën tonë dhe për dashurinë e tyre për Kosovën, kryeministri Kurti i falënderoi ata për bisedat e frytshme.

KQZ-ja javën tjetër diskuton për verifikimin e nënshkrimeve për shkarkim të kryetarëve në veri

Prishtinë, 1 mars - Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) javën tjetër do të diskutojë lidhur me procesin e verifikimit të

nënshkrimeve të mbledhura për organizim të zgjedhjeve për shkarkimin e kryetarëve në katër komunat me shumicë serbe. Kështu ka

bërë me dije të premten kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi. "Javën tjetër do ta trajtojmë atë çështje. Do të jemi në një mbledhje të tillë.

Paraprakisht do të miratojmë disa rregullore të brendshme që janë të nevojshme", është shprehur Radoniqi.





Konjufca: BE-ja s'ka kompetencë t'i propozojë Kosovës draft-statut për Asociacionin

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë të premtën se Bashkimi Evropian (BE) nuk ka kompetencë t'i propozojë Kosovës një draft-statut për formimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe. “Nuk mendoj se është kompetencë e BE-së t'i propozojë draft Kosovës dhe Kosova të qëndrojë gatitu dhe ta dërgojë draftin që BE-ja e propozon. Nuk pajtohem me këtë procedurë”, ka thënë Konjufca. Një ditë më parë ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka treguar se e ka këshilluar Qeverinë e Kosovës ta kërkojë sa më shpejt mendimin e Gjykatës Kushtetuese për një draft-statut të hartuar vitin e kaluar prej Perëndimit për themelimin e Asociacionit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë të premtën se Bashkimi Evropian (BE) nuk ka kompetencë t'i propozojë Kosovës një draft-statut për formimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe, megjithëse autoritetet e Kosovës e kanë pranuar një të tillë tashmë nën ndërmjetësimin e bllokut. “Mendoj se Bashkimi Evropian nuk ka kompetencë t'i propozojë Asociacion Kosovës. Është gabim të mendosh se është kompetencë e BE-së të na caktojë neve [draft-status për Asociacionin], kurse kompetencë e jona të jetë ta dërgojmë atë në Gjykatën Kushtetuese. Nuk mendoj se është kompetencë e BE-së t'i propozojë draft Kosovës dhe Kosova të qëndrojë gatitu dhe ta dërgojë draftin që BE-ja e propozon. Nuk pajtohem me këtë procedurë”, ka thënë Konjufca pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, i cili po u përgjigje

pyetjeve rreth deklaratës së ambasadorit amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier.

Ky i fundit tha një ditë më parë se e ka këshilluar Qeverinë e Kosovës ta kërkojë sa më shpejt mendimin e Gjykatës Kushtetuese për një draft-statut të hartuar vitin e kaluar prej Perëndimit për themelimin e Asociacionit. “Do të ekzistojë një përgjigje nëse [dokumenti] është kushtetues apo jo, do të dihet a ka kompetenca ekzekutive apo jo, dhe mendojmë se vetëm Gjykata mund ta japë atë vlerësim. Diçka e tillë do të krijojë një dinamikë ndryshe dhe do ta reflektojë përkushtimin e Kosovës për t'i përmbushur obligimet që ka”, ka pohuar Hovenieri të enjten gjatë një bashkëbisedimi me gazetarë në ndërtesën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Në tetor të vitit të kaluar, diplomatët perëndimorë i paraqitën Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për formimin e Asociacionit, i cili u hartua nga BE-ja dhe të cilin palët thanë se e

pranojnë.

Në lidhje me këtë dokument, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte siguruar asokohe se është shkruar “me kujdes dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës”.

Kosova dhe Serbia së pari arritën marrëveshje për Asociacionin më 2013, më pas edhe më 2015 mbi parimet për themelimin e tij.

“Për dinarin duhet ta gjejmë modalitetin më të mirë, që serbët lokalë të mos ndihen të kërcënuar”

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas përfundimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka folur edhe për tensionimin e raporteve me ShBA-në për çështjen e dinarit. Ai ka thënë se reagimi i ShBA-së lidhet pikërisht me dinarin dhe jo me Asociacionin. Ai ka thënë se ShBA-ja ka shprehur mospajtim për aspektin kohor dhe për shpejtësinë me të cilën është marrë vendimi, duke kërkuar konsultime me komunitetin serb. Ai ka thënë se ShBA-ja s'po e konteston legalitetin e vendimit. “Më shumë ka qenë çështja e dinarit që ka sjellë deri tek ky reagim i ShBA-së. Qeveria ka dhënë shpjegimet e veta, që është mirë që mospajtimin e kemi vetëm për aspektin kohor edhe për nga shpejtësia ndoshta që është bërë, do të mund të kishte kohë më shumë. Ata kanë kërkuar më shumë konsultime me komunitetin serb që jeton në veri të Kosovës, por legaliteti i

vendimit nuk po kontestohet”, ka thënë Konjufca.

Konjufca ka shtuar se vendimi për valutën është e drejtë e Kosovës dhe se duhet gjetur modaliteti më i mirë për zbatim, që të ndalet praktika e keqe e futjes së dinarit në Kosovë që në të njëjtën kohë komuniteti serb të mos ndihet i kërcënuar apo i destabilizuar nga vendimi. “Kjo është një e drejtë e Kosovës që duhet t'ia gjejmë modalitetin më të mirë se si zbatohet që të përfitojnë të gjithë, që të ndalet kjo praktikë e keqe e parave ‘cash’ që hyjnë me miliona e miliona dinarë drejt në territorin e Kosovës. Në të njëjtën kohë që komuniteti serb të mos ndihet i kërcënuar apo i destabilizuar nga vendime të tilla. Unë mendoj se kjo është e mundshme të arrihet. Nuk është vështirë të gjendet një modalitet i tillë”, ka deklaruar Konjufca.

“Pas 24 shtatorit, gjëja më absurde që ka ndodhur prej Bashkësisë Ndërkombëtare është që Kosovës t'i vazhdohen masat”

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se pas 24 shtatorit, kur edhe ndodhi sulmi në Banjskë, gjëja më absurde nga Bashkësia Ndërkombëtare është që Kosovës t'i vazhdohen masat. “Pas 24 shtatorit gjëja më absurde që ka ndodhur prej bashkësisë ndërkombëtare është që Kosovës t'i vazhdohen masat e ndërkohë Serbia, e cila është vend drejtpërdrejt sponsorizues i këtij

grupi terrorist, e ka sulmuar Kosovën më 24 shtator. Kjo është vërtetuar edhe prej informatave të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore që ky grup ka shfrytëzuar institucionet e sigurisë së shtetit të Serbisë për t'u trajnuar e për t'i kryer përgatitjet. Kemi gjetur edhe lidhje të drejtpërdrejta të armatimit me Ministrinë e Mbrojtjes së Serbisë dhe lidhjen e eksponentëve terroristë të lidhur drejtpërdrejt me zyrtarë të lartë shtetërorë të Serbisë. Tash ndërkombëtarët disa e thonë e disa nuk e thonë, disa e thonë në pëshpëritje, por kjo duhet të thuhet haptazi dhe në raporte që publikohen dhe që mbajnë Serbinë përgjegjëse për këtë sulm”, ka theksuar Konjufca.

Ai ka shtuar se qëndrimi i Parlamentit Evropian i cili ka bërë thirrje për t'ia hequr Kosovës masat, duhet të bëhet edhe qëndrim i qeverive evropiane. “Me të vërtetë nuk mund ta kuptoj që Kosovës ende i vazhdohen masat e vendosura nga BE-ja. Parlamenti Evropian ka qenë gjithmonë krah Kosovës dhe popullit të saj. Më kujtohen mua edhe ngjarje të mëhershme të cilat janë të rëndësishme për Kosovën, dhe do të ishte mirë që ky qëndrim i PE-së të bëhet edhe qëndrim i qeverive evropiane. Ne e dimë që qeveritë evropiane mundohen ta gjejnë një mes me Serbinë, por këtu nuk ka mes dhe nuk ka kurrfarë balancimi. Këtu ka qenë një akt terrorist i 24 shtatorit, heroi Afrim Bunjaku u vra nga terroristët që hynë nga Serbia dhe kjo është një e vërtetë që nuk mund ta fshehë askush. Qeveritë evropiane duhet ta pranojnë”, ka thënë Konjufca.

Aleksei Navalny varroset në Moskë

MOSKË, 1 MARS - Mijëra persona me lule në duar, të rrethuar nga forcat e sigurisë, ia kanë dhënë lamtumirën e fundit kritikut të Kremlinit, Aleksei Navalny, i cili është varrosur të premten në varrezat Borisovskoye në Moskë.

Ka raportime se në momentin e varrosjes së trupit të tij është dëgjuar kënga "My Way" e Frank Sinatra.

Ai ka vdekur më 16 shkurt në një burg rus në Arktik në rrethana misterioze.

Para varrimit, në Kishën "Ikona e Nënës dhe Zotit", është mbajtur një ceremoni përkujtimore, në të cilën kanë marrë pjesë edhe prindërit e tij.

Prindërit Anatolij dhe Lyudmila nuk kanë bërë ndonjë koment publik.

Ka pasur njerëz që u janë afruar prindërve duke u thënë "faleminderit për birin tuaj" dhe "na falni".

Disa persona janë dëgjuar duke bërtitur jashtë kishës, "ekzekutues", "Rusia do të jetë e lirë", "jo luftës". Të tjerë kanë thënë duke qarë, "nuk do të të harrojmë".

Ceremonia është mbajtur te kisha në qarkun Marjino, ku ka jetuar Navalny për një kohë, sipas ish-



zëdhënësës së tij Kira Yarmysh.

Diplomatë të huaj, përfshirë ambasadorët e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Francës, kanë shkuar në kishë për ta nderuar Navalnyn.

Ata janë parë të veshur në të zeza dhe me trëndafilat në duar.

Në rrugën drejt kishës janë vendosur shumë gardhe metalike. Të paktën 40 makina të policisë janë parkuar afër kishës në mëngjesin e 1 marsit.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, e ka lëshuar një paralajmërim përmes gazetarëve se çdo organizim i paligjshëm do të konsiderohet shkelje e ligjit, një lloj kërcënimi që policia do të intervenonte shpejt nëse duhet të merret me turmat.

Ai ka thënë se Kremlini nuk e konsideron Navalnyn si politikan dhe nuk ka asgjë për të thënë për familjen e Navalny.

Në ceremoninë ortodokse, njerëzit zakonisht parakalojnë para trupit të të vdekurit, për t'i dhënë lamtumirën e fundit, dhe më pas ceremonia udhëhiqet prej një prifti dhe më pas një kori.

Qindra rusë janë arrestuar vetëm pse kanë dërguar lule nëpër qytet për ta përkujtuar Navalnyn.



Komandanti Walker: Paqeruajtësit amerikanë të gatshëm ta parandalojnë dhunën në veri

PRISHTINË, 1 MARS - "Trupat paqeruajtëse amerikane në Kosovë janë të pajisura mirë dhe të gatshme për ta parandaluar dhunën në veri të vendit", ka deklaruar komandanti i ushtarëve amerikanë nga Garda Kombëtare e Ushtrisë së Teksasit, Ross Walker, në një intervistë për "Reuters".

NATO ka përforcuar praninë e saj në Kosovë me 1 000 trupa të tjera pas sulmit të 24 shtatorit në Banjskë, ku mbeti i vrarë polici Afrim Bunjaku.

Më shumë se 570 ushtarë amerikanë shërbejnë në misionin e udhëhequr nga NATO, i cili në total ka rreth 4 500 trupa të dislokuara. "Ne jemi të përgatitur mirë, të trajnuar mirë dhe të pajisur për të reaguar ndaj çdo gjëje që mund të ndodhë

këtu tani", ka thënë kolonel Ross Walker, transmeton Telegrafi. "Edhe pse jemi të gatshëm të reagojmë ndaj çdo gjëje, dëshira jonë është që gjithmonë t'i bëjmë gjërat fillimisht përmes një dialogu paqësor".

Disa nga ushtarët amerikanë janë të vendosur në kampin Nothing Hill afër qytetit verior të Leposaviqit dhe rrugëve të patrullimit që lidhin Kosovën dhe Serbinë. Ata i parkojnë kamionët e tyre të bardhë të paarmatosur afër kufirit me Serbinë dhe më pas ecin pranë hekurave metalike që deri vonë mbanin tabela që sinjalizojnë vijën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ata patrullojnë në këmbë dhe mbajnë vetëm pistoletat, shenjë se gjërat kanë qenë të qeta kohët e fundit.



Synohet ulja e numrit të rasteve të dhunës në familje në Prizren

PRIZREN, 1 MARS - Organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ku i pranishëm ishte edhe ambasadori Michael Davenport, kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir

Totaj, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi për riaktivizimin e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, me të gjithë aktorët e

përfshirë në këtë çështje. "Me këtë rast u zotuan se do të kërkojnë edhe mbështetje shtesë nga institucionet qendrore derisa të fuqizohet edhe më tej bashkëpunimi

me të gjitha institucionet relevante për ta ulur numrin e rasteve të dhunës në familje në komunën e Prizrenit", ka njoftuar komuna e Prizrenit.



Krasniqi: Kosova ka nevojë edhe për përkrahjen e Turqisë

PRISHTINË, 1 MARS - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, në ditën e parë të pjesëmarrjes në Forumin Diplomatik të Antalisë, para hapjes zyrtare nga presidenti Rexhep Tajip Erdogan, ka takuar zëvendësministrin e Jashtëm të Turqisë, Mehmet Kemal Bozay. Zhvillimet në Kosovë, rajon dhe Evropë ishin tema të diskutimit, për të cilat të shkëmbyen pikëpamjet e tyre. "Zëvendësministrin Kemal Bozay e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë në të gjithë sektorët dhe në të gjitha etapat e shtetndërtimit të vendit tonë - përfshirë kontributin e çmuar në fushën e sigurisë, tashmë edhe përmes udhëheqjes së misionit të KFOR-it. Kosova ka nevojë edhe për përkrahjen e Turqisë te shtetet e ndryshme, për t'i bindur që ta njohin Kosovën, por edhe në forumet ndërkombëtare, për ta përkrahur anëtarësimin e Kosovës, posaçërisht në NATO dhe në Këshillin e Evropës", ka thënë Krasniqi.

Ai ka shtuar se zëvendësministrin Mehmet Kemal Bozay e ka siguruar që përtej veprimeve të papërgjegjshme të qeverisë, populli i Kosovës dhe PDK-ja mbesin të përkushtuar për t'i ruajtur dhe kultivuar edhe më tutje aleancat më të fuqishme, përfshirë atë me Turqinë.



Nënshkruhet memorandumimi për ofrimin e zbritjes në produkte për zjarrfikësit dhe zyrtarët policorë



PRISHTINË, 1 MARS - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, në shoqërim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, Gazmend Hoxha dhe drejtorit të Departamentit të Gatishmërisë në kuadër të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, Mustafë Gashi, ka pritur në takim kryetarin e Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, i shoqëruar nga anëtarët e bordit të AKB-së, Shkëlzen Jusaj, Xhevdet Rexhepi dhe Lumnije

Ajdini. Ky takim i parapriu nënshkrimin të memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Aleancës Kosovare të Bizneseve përmes të cilit do të ofrohen zbritje në produkte dhe shërbime në bizneset anëtare të AKB-së për pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe zjarrfikësit e Kosovës. Ky memorandum bashkëpunimi do të ofrojë zbritje për zyrtarët

policorë dhe zjarrfikësit në produkte dhe shërbime nga 5-50% në sektorin e ushqimit, veshmbathjeve, derivateve të naftës, shërbime mjekësore, shërbime juridike, transport me taksë, hoteleri dhe gastronomi, si dhe qiramarrje të mjeteve. Pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe Zjarrfikësit do të njoftohen për fazat e implementimit të kësaj marrëveshjeje përmes personave të caktuar brenda institucioneve të tyre.

Hedhja e gazit lotsjellës në Kuvend, Konjufca: Befasi për mua që u lirova tërësisht nga akuza

Prishtinë, 1 mars - Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se është befasuar me vendimin e Gjykatës Themelore lidhur me akuzën për përdorim të armës ose mjetit të rrezikshëm lidhur me hedhjen e gazit lotsjellës në mbledhjen e kryesisë më 18 gusht 2016. Ai ka thënë të premten se ka

pritur që të dënohej me kusht ose me gjobë. "Ky është një proces që është zvarritur së tepërmi. Nuk ka qenë proces gjyqësor me standarde të njëjta. Kanë ndodhur dënime me kushte e me gjoba. Në momentin që nuk është vendosur përmes një kriteri të njëjtë, unë mendoj që qysh në atë kohë

gjykata i ka ndërruar standardet dhe pastaj as unë vetë nuk e kam ditur çfarë dënimi do të më presë. Por, që lirohem krejt, ka qenë befasi edhe për mua. Kam pritur që të jetë dënim ose me kusht ose me gjobë. Nuk do ta kisha problem që të jem i dënuar", ka thënë Konjufca.



PDK-ja: Qeveria Kurti ka dështuar në garantimin e sigurisë kombëtare



PRISHTINË, 1 MARS - Koordinatorja e Departamentit për Mbrojtje dhe Siguri Kombëtare në Kabinetin për Qeverisje të Mirë e PDK-së, Besa Kabashi-Ramaj, ka kritikuar qeverinë Kurti për mungesë vizioni dhe aftësie për garantimin e sigurisë kombëtare dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbrojtjes. Kabashi-Ramaj, në një konferencë për media, ka theksuar se kjo qeveri ka mangësi të konsiderueshme për të kuptuarit e partneriteteve strategjike, veçanërisht me ShBA-në. "Qeveria ka dështuar vazhdimisht të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj provokimeve dhe kërcënimeve serbe, t'i kundërvihet luftës hibride ruse dhe t'i menaxhojë çështjet e sigurisë së brendshme, duke përfshirë integrimin e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes, rritjen e qëndrueshmërisë kombëtare

dhe përmirësimin e menaxhimit të emergjencave dhe sistemeve të paralajmërimit të hershëm", tha ajo. Sipas Kabashi-Ramajt, shembulli më flagrant i favorizimit të lëvizjeve populiste për planifikimin strategjik të sigurisë është ngritja e fondit vullnetar për ushtrinë me praktika të dyshimta financiare, duke anashkaluar procedurat standarde të buxhetit. Ajo vlerësoi se hartimi i strategjisë së sigurisë kombëtare është dëmtuar rëndë nga vlerësimet e vjetruara të sigurisë, mungesa e kostimit dhe prioritizimi i dobët. "Iniciativat legislative si Projektligji për Inteligjencën Ushtarake dhe Projektligji i Këshillit të Sigurisë Kombëtare shfaq të meta të rëndësishme, duke treguar një mospërfillje të strukturave ekzistuese dhe një qasje alarmante për shpërbërjen e institucioneve

tashmë ekzistuese dhe rindërtimin nga e para. PDK-ja synon të zhvillojë një platformë largpamëse të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes për 10 deri në 20 vitet e ardhshme, duke u fokusuar në vizionin, njohurinë, kompetencën dhe inovacionin, të dobishme për të gjithë qytetarët. Qëllimi ynë është të krijojmë një Republikë të Kosovës të sigurt, agjile dhe strategjiksht të pozicionuar dhe të aftë për t'iu kundërvënë kërcënimeve të reja", theksoi Kabashi-Ramaj. Ajo ka rekomanduar që të rishikohet në tërësi Projektligji për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës, sepse rrezikon t'i çmontojë strukturat ekzistuese ligjore, duke dërguar në humbjen e kujtesës institucionale dhe duke shkelur potencialisht të drejtat e punonjësve, sepse mund t'i japë kryeministrit kontroll të tepruar.

"Struktura e detajuar mund të sjellë pengesa burokratike, veçanërisht në raste emergjence. Takimet e rralla mund t'i pengojnë përgjigjet në kohë ndaj kërcënimeve të sigurisë. Paqartësitë ligjore mund të lindin nga dyfishimet me ligjet ekzistuese dhe shfuqizimi i ligjit të mëparshëm. Mandati i kufizuar për Drejtorinë e Përgjithshme mund të ndikojë negativisht në planifikimin strategjik dhe stabilitet. Sanksionet disiplinore në projektligj mund të jenë subjekt i keqpërdorimit ose aplikimit subjektiv", theksoi koordinatorja e Departamentit për Mbrojtje dhe Siguri Kombëtare në KQM. Sa i përket Projektligjit për Inteligjencën Ushtarake, Kabashi-Ramaj, tha se deklarata e misionit i mungon qartësia, duke çuar në konfuzion rreth objektivave të

agjencisë. "Struktura raportuese ka të meta, duke dështuar në pozicionimin e duhur të FSK-së në zinxhirin komandues. Autorizimi i përdorimit të forcës është i diskutueshëm dhe potencialisht i papërshtatshëm. Dispozitat e mbikëqyrjes brenda kufijve të vendit mund t'i cenojnë liritë civile. Ka dyfishime me detyrat që tashmë ka AKI. Përrjashtimi i buxhetit të Operacioneve Speciale nga rregullat standarde financiare ngrë shqetësime për transparencën", theksoi ajo. Kabashi-Ramaj tha se Kosova është e qytetarëve të saj dhe meriton një të ardhme të sigurt dhe shpresëdhënëse. "Siguria kombëtare, një çështje jetike, është e rrezikuar nga politikat aktuale të qeverisë. Nevojitet veprim urgjent për ta parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të sigurisë së Kosovës", përfundoi ajo.

Tahiri thotë se AAK-ja do t'i mbështesë marrëveshjet ndërkombëtare, por ka edhe dy kërkesa



PRISHTINË, 1 MARS - Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë të premten se kjo parti do t'i mbështesë marrëveshjet ndërkombëtare përdorim të detyrës së kësaj kërkesa eksplicite që të ketë reflektim mbi dy kërkesat që ka ky subjekt politik: të votohet rezoluta për sigurimet shëndetësore si dhe

amandamentimi i Ligjit të Pagave. "Sa i përket çështjes së dinarit, qëndrimi ynë është i saktë: Euro është valuta e vetme në Kosovë dhe ajo duhet të jetë. Për këtë temë duhet të ketë diskutim të brendshëm në Kosovë me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe me argumentimet që i ka qeveria në mënyrë që të arrihet deri te një zgjidhje dhe assesi kjo temë nuk duhet të bëhet temë e

dialogut në Bruksel. Është fatkeqësi e madhe, që ky vendim i brendshëm i Bankës Qendrore të Kosovës të bëhet temë ndërkombëtare! Të gjithë hapat e qeverisë kanë qenë dhe janë të gabuar. Është dashur të ketë një njoftim paraprak, të jepet një afat kohor dhe të merret një vendim i pakthyeshëm, dhe jo kjo çështje të bëhet problem ndërkombëtar", ka thënë Tahiri.

Javën e ardhshme mbahen dy seanca, njëra për nder të Epopesë së UÇK-së

Prishtinë, 1 mars - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se javën e

ardhshme Kuvendi do të mbajë dy seanca: njëra për nder të Epopesë së UÇK-së. "Kuvendi do të mbajë një seancë të martën më 5

mars, nga ora 10:00, e cila shënon 26-vjetorin e Epopesë së UÇK-së. Ndërsa nga mbledhja që u mbajt sot, kryesia u

dakordua që më 7 mars, në orën 10:00, të ketë seancë me disa pika të rendit të ditës", ka deklaruar Kusari-Lila.



ISA-t e Rrjetit diskutojnë për ndikimin e auditimit në përmirësimin e llogaridhënies financiare të buxhetit të shtetit

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 1 mars - Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca, zëvendësauditore e përgjithshme Beza Halilaj dhe ndihmësauditore e përgjithshme Agron Fetiu morën pjesë në konferencën dyditore me temën "Auditimi i llogarisë përfundimtare të buxhetit të shtetit", organizuar nga Institucioni Shtetëror i Auditimit të Malit të Zi me mbështetjen e SIGMA në Budva të Malit të Zi më 28 dhe 29 shkurt 2024.

Aktiviteti është realizuar në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) të vendeve kandidatë dhe kandidatë të mundshme për anëtarësim në BE. Pjesë e delegacionit të Kosovës ishte edhe u. d. drejtor i Thesarit, Nysret Koca.

Në panelin e diskutimit me temën "Roli i këshilluesit në reformat e buxhetimit dhe kontabilitetit dhe pozicioni i tyre i pavarur në sektorin publik", Halilaj paraqiti përvojën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të

Republikës së Kosovës lidhur me rolin e ISA-ve në reformat e kontabilitetit publik dhe buxhetit si dhe ushtrimin e rolit këshillues dhe ruajtjen e pozicionit të pavarur.

Ai tregoi se çështjet e ngritura nga ZKA-ja ndër vite lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit, menaxhimin dhe kontrollin e shpenzimeve, kontabilitetin dhe raportimin financiar e të tjera, janë adresuar nga Qeveria e Kosovës përmes Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës 2022-2026.

Ai tha se, përveç mandatit rekomandues, ZKA-ja ka edhe rol këshillues për t'i ndihmuar institucionet publike për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Kryetari i Senatit të Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, Nikola N. Kovaçević, deklaroi se menaxhimi efektiv dhe transparent i financave publike kërkon administrimin e mirë të një sërë sistemesh dhe njëri prej tyre është auditimi i jashtëm, i cili në mënyrë



objektive dhe të paanshme kontrollon menaxhimin e shpenzimeve publike.

Ndërsa zëvendës drejtoresha e Programit SIGMA, Bianca Breteche, tha se SIGMA e ka mbështetur Rrjetin që nga themelimi i tij dhe se kjo konferencë është mundësi e

mirë për ta ndarë përvojën dhe njohuritë si dhe për të parë se çfarë është bërë deri tani dhe çfarë mund të bëhet për të pasur më shumë rezultate.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të ISA-ve nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Gjeorgjia,

Kosova, Republika e Moldavisë, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia, Ukraina, ekspertë nga ISA të Kroacisë, Sllovenisë, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave të Malit të Zi, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Bizneset njoftohen me procedurat e zbatimit të nënshkrimit elektronik

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë së fundmi organizoi një punëtori interaktive të fokusuar në krijimin e identitetit digjital dhe proceset e nënshkrimit elektronik, ku morën pjesë ekspertët e industrisë, Agim Kukaj, drejtor i Departamentit të TIK në Ministrinë e Ekonomisë, si dhe Gazmend Selmani nga PBC Group.

Ndër pikat kryesore të cilat u theksuan gjatë kësaj punëtorie ishin vlefshmëria e njëjtë e nënshkrimit elektronik dhe atij fizik, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Vlen të përmendet se nënshkrimi elektronik është i besueshëm dhe ligjërish i aplikueshëm në të gjitha proceset dhe duhet të pranohet nga të gjitha institucionet, duke



përjashtuar disa raste të veçanta siç është nënshkrimi i kontratës për blerjen e patundshmërisë apo çështjeve trashëgimtare.

Për më tepër, folësit theksuan rëndësinë e nënshkrimit

elektronik si një mjet i cili shkurton kohën e kryerjes së proceseve dhe ul kostot e shumë shërbimeve.

Agim Kukaj foli për përpjekjet e vazhdueshme të Ministrisë së Ekonomisë së bashku me

partnerët e saj që punoi shumë për të vënë në fuqi ligjin dhe legjislacionin. "Tani, përmes projektit të financuar nga BE-ja, Ministria po sjell ofertat e teknologjisë për të mundësuar nënshkrimin elektronik për qytetarët dhe vulat elektronike për bizneset, me plane për funksionalizimin e plotë deri në fund të shtatorit". Ai theksoi se vulat elektronike do t'u ofrohen bizneseve me një çmim të arsyeshëm.

Kukaj theksoi masat proaktive të ndërmarra nga institucionet publike me qëllim të integritetit të këtyre sistemeve. Ai shtoi se ligji u mundëson bizneseve dhe individëve t'i përdorin nënshkrimet elektronike në aktivitetet e tyre të përditshme. Megjithatë, ai vuri në dukje rëndësinë e krijimit të fushatave të cilat rrisin kuptimin dhe përfitimet

e përdorimit të nënshkrimeve elektronike dhe identitetit digjital. Në anën tjetër, Gazmend Selmani u thellua në tema kryesore si krijimi i shpejtë i nënshkrimit elektronik dhe vulave elektronike të avancuara për bizneset, të ndihmuara nga rTrust, një shërbyes i besueshëm i kualifikuar, implementuar nga PBC Group, i akredituar në Bashkimin Evropian, dhe i njohur nga Qeveria e Kosovës.

Selmani theksoi besueshmërinë e protokolleve të vërtetimit të rTrust dhe teknologjinë e avancuar të përdorur për verifikimin e 'gjallërisë', duke rritur besueshmërinë e përgjithshme të produktit. Për më tepër, për sa i përket vërtetimit, certifikata digjitale e lëshuar nga një autoritet i besuar siguron të gjitha palët për autenticitetin e pjesëmarrësve në komunikim.

Murati takon Cummingin, temë diskutimi thellimi i ndërveprimit ekonomik Kosovë - Britani

PRISHTINË, 1 MARS - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka pritur në takim Fergus Cumming, zëvendës shef për Ekonomi në Zyrën për Zhvillim dhe Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar (FCDO). Gjatë takimit, ministri Murati e njoftoi Cummingin për disa nga prioritetet e qeverisë, siç janë rritja e punësimit dhe krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Rritja ekonomike si dhe thjeshtimi i procedurave

tatimore në vitet e fundit u konsideruan tregues për përshtatshmërinë e Kosovës në tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Fokus i takimit ishte thellimi i ndërveprimit ekonomik mes dy vendeve ku u përmendën disa sektorë potencialë për investime përfshirë: minierat, kapacitetet e reja energjetike, teknologjinë e informacionit si dhe industrinë e përpunimit të drurit.

Zëvendës shefi Cumming e

vlërsi potencialin e Kosovës për bashkëpunim të ndërsjellë, duke theksuar nevojën për rritje të tregtisë dypalëshe. Ndër të tjera, Cumming premtoi vazhdim të mbështetjes së Republikës së Kosovës drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës ekonomik.

Të dyja palët u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në fusha të cilat janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe për rritje të vëllimit tregtar në mes të dy vendeve.



Cili ishte revolucioni politik më i rëndësishëm is shekullit XX?

Një revolucion i veçantë ishte aq i rëndësishëm, sa të paktën një historian mendon se shekulli i 20-të filloi zyrtarisht në 1914 dhe përfundoi në 1991.



Është e vështirë të thuhet se cili revolucion ishte më i rëndësishmi, qoftë edhe sepse historianët ende nuk pajtohen se çfarë janë në të vërtetë revolucionet. Nëse rëndësia përcaktohet në terma të shtrirjes ndërkombëtare, atëherë revolucionet komuniste të Rusisë dhe Kinës do të ishin dy pretendentët më të fortë. Në vend që të kërkojnë ngjashmëri midis revolucioneve, historianët modernë fokusohen në atë që e bën çdo konflikt unik.

Pyetja, “Cili ishte revolucioni politik më i rëndësishëm i shekullit të 20-të?” është sa problematike, aq edhe e vështirë për t’iu përgjigjur, dhe kjo për një sërë arsesh. Një nga këto është se historianët ende nuk kanë rënë dakord për një përkufizim të duhur se çfarë është dhe çfarë nuk është një revolucion. Termi përdoret më së shpeshti për t’iu referuar një periudhe trazirash sociale dhe politike, por mund të përdoret gjithashtu, më gjerësisht, për t’iu referuar një periudhe ndryshimesh drastike, jopolitike, si revolucionet industriale ose shkencore.

Pastaj vjen pyetja se cilat ngjarje duhet dhe nuk duhet të konsiderohen revolucione. Historianët profesionistë kanë shumë pak gjëra për të cilat mund të bien dakord. Disa historianë, për shembull, argumentojnë se Lufta Civile Amerikane duhet të konsiderohet një zgjatje e Revolucionit Amerikan – një përpjekje e dytë për të çliruar vendin nga autokracia, këtë herë në formën e skllavërisë. Po kështu, ka historianë që argumentojnë se

Revolucioni Francez, ndoshta revolucioni më i famshëm i të gjitha kohërave, nuk ishte në të vërtetë një revolucion.

Pasi një ngjarje kualifikohet si revolucion, pyetja tjetër është të përcaktohet nëse ishte “më e rëndësishmja” e kohës së vet. Kjo është veçanërisht e ndërlikuar, pasi rëndësia historike e ngjarjeve të së kaluarës ndryshon vazhdimisht me kalimin e kohës. Siç thekson profesori i Universitetit të Columbias, Richard Bulet, në një leksion mbi historinë e shekullit të 20-të që u postua në YouTube, historianët fillimisht nuk i referoheshin Luftës së Parë Botërore si “Lufta e Parë Botërore”. Ky emër iu dha vetëm pasi ndodhi Lufta e Dytë Botërore.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, ka nga ata që besojnë se renditja e ngjarjeve historike për nga rëndësia, është e konceptuar gabim. Në të kaluarën, studiuesit përpiqeshin ta kthenin studimin e revolucionit në një shkencë të vështirë. Ata besonin se kishte ligje që rregullonin sjelljen njerëzore dhe

se, duke i kuptuar ato ligje, ne mund të zbulonim pse disa revolucione kanë sukses, ndërsa të tjerët dështojnë. Kohët e fundit, komuniteti akademik ka ecur drejt një studimi kulturor të revolucioneve – në vend që të shikojnë ngjashmëritë midis konflikteve, historianët tani janë më të interesuar në atë që e bën çdo konflikt unik.

Megjithatë, sado të kontestuara të jenë këto lloj pyetjesh, ato na ftojnë të mendojmë në mënyrë kritike për ngjarjet e kaluara. Edhe pse nuk mund ta dimë kurrë me siguri se cili revolucion i shekullit të 20-të ishte “më i rëndësishmi” (nëse dikush duhet ta pretendojë atë titull), ne duhet të largohemi nga kjo përpjekje duke patur një kuptim më të thellë të disa prej momenteve më vendimtare të 100 viteve të fundit, për të mos përmendur shtrirjen e tyre ndërkombëtare dhe ndër-breza.

Revolucioni i Tetorit i vitit 1917

Në shkurt 1917, një kryengritje në Shën Petersburg çoi në heqjen dorë nga fronin prej Carit Nikolla II dhe krijimin e një qeverie të përkohshme, të përbërë nga shumë parti të ndryshme socialiste që kishin hedhur rënjtë në Rusi gjatë dekadave të mëparshme. Gjatë vjeshtës së po atij viti, një nga ato parti, bolshevikët, përfitoi nga kaosi dhe konfuzioni i Luftës së Parë Botërore, për të nxjerrë jashtë funksionin qeverinë e përkohshme dhe për të krijuar një shtet të vetin. Pas çimentimit të sundimit të tyre

në një luftë të përgjakshme civile, bolshevikët, të cilët deri atëherë ishin riemërtuar si Partia Komuniste, e transformuan vendin. Para marrjes së pushtetit, Rusia shpesh përshkruhej si një komb i prapambetur dhe rusët e zakonshëm përjetonin një cilësi jete që nuk ishte parë në Evropë, që nga Mesjeta. Por në kohën kur Bashkimi Sovjetik u shemb, Rusia ishte transformuar në një superfuqi të armatosur me armë bërthamore. Udhëheqësi i partisë Vladimir Lenini, besonte se Revolucioni i Tetorit mund të shërbente si shkëndija që do ndizte kryengritjen proletare globale për të cilën kishte shkruar Karl Marksi. Megjithatë kjo nuk ndodhi, eksperimenti komunist i Rusisë inkurajoi revolucionarët anembanë globit, duke çuar në krijimin e shteteve komuniste, apo socialiste në Kinë, Indi, Kubë, Vietnam, Kore Shqipëri dhe Kamboxhia, ndër të tjera.

Revolucioni i Tetorit mund të konsiderohet gjithashtu i rëndësishëm, për aq sa krijoi një shoqëri të aftë për të ndaluar përhapjen e nazizmit. Beteja e Stalingradit, e cila ndodhi jo shumë larg kufirit me Ukrainën, konsiderohet gjerësisht si konfrontimi ushtarak më vendimtar në Luftën e Dytë Botërore, si dhe fillimi i fundit për Rajhun e Tretë. Si rezultat i drejtpërdrejtë i fitores, BRSS fitoi kontrollin mbi Evropën Lindore, duke mbikëqyrur rindërtimin e pasluftës duke zbatuar legjislacionin komunist.

Prania komuniste në Evropë la një ndikim të qëndrueshëm në të dy


anët e Perdes së Hekurt. Në lindje, pjesa më e madhe e infrastrukturës qeveritare të pasluftës, e zbatuar nga sovjetikët mbetet e paprekur sot. Sa i përket perëndimit, historiani britanik E.H. Carr vërejtë qysh në vitin 1946 se “shembulli sovjetik, me dashje apo pa dashje, kishte ndihmuar në nxitjen e reformave në Evropën Perëndimore”.

Shekulli i shkurtër i 20-të: 1914-1991

Aq domethënëse ishin pasojat e Revolucionit të Tetorit sa historiani Eric Hobsbawm propozoi data alternative për të shënuar fillimin dhe fundin e shekullit të 20-të. Në vend të vitit 1900, Hobsbawm pohon se shekulli i 20-të filloi me të vërtetë rreth vitit 1914, pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, dhe përfundoi në vitin 1991, me rënien e BRSS dhe shpërbërjen e Partisë Komuniste në Rusi, duke krijuar kriza ekonomike për shtetet satelite komuniste.

Hobsbawm e propozoi këtë në veprën e tij kryesore, Epoka e ekstremeve: Shekulli i shkurtër i njëzetë, 1914–1991. Këto vite shënojnë kufijtë jo të një shekulli kronologjik, por të një periudhe kohe të bashkuar nga një zeitgeist i përbashkët, një ide qendrore që dukej se qëndronte në zemër të pothuajse çdo konflikti që ndodhi. Siç e sheh Hobsbawm, komunizmi ishte një nga meta-narrativat më këmbëngulëse që u përpoq të zëvendësonte boshllëkun e lënë nga feja.

Në vitin 1991, historia botërore filloi



zyrtarisht një kapitull të ri, i cili do të adoptonte një narrativë të ndryshme, nga ajo komunizëm kundër kapitalizmit. “Me rënien e BRSS, eksperimenti i ‘socializmit real ekzistues’ mori fund”, shpjegon Hobsbawm në librin e tij. “Sepse, edhe aty ku regjimet komuniste mbijetuan dhe patën sukses, si në Kinë, ata braktisën idealin original të një ekonomie të kontrolluar nga qendra dhe të planifikuar nga shteti, bazuar në një shtet tërësisht të kolektivizuar... A do të rinovohet ndonjëherë ky eksperiment?”

Ndërsa Bashkimi Sovjetik konsiderohet sot si një gjë e së kaluarës, Revolucioni i Tetorit nuk është. Siç thekson historiani amerikan Michael Kort në një artikull të shkruar për blogun e Oxford University Press, Revolucioni i Shkurtit i vitit 1917 (kur autokracia mori fund dhe një u krijua për pak kohë një republikë) shënoi pikën kur ndikimi perëndimor në Rusi ishte në kulmin e të gjitha kohërave, ndërsa Revolucioni i Tetorit shënoi pikën kur ky ndikim kulturor, politik dhe ekonomik ishte në nivelin më të ulët historik, duke i dhënë jetë një tendence, që do të vazhdonte gjatë. “Midis 1985 dhe 1999,” shkruan Kort, “Mikhail Gorbachev dhe më pas Boris Yeltsin u përpoqën ta çonin Rusinë përsëri drejt Perëndimit. Por asnjë nga liderët nuk mund të kapërcente pengesën e madhe të Revolucionit Rus. Si Gorbacovi ashtu edhe Jelcini përfundimisht u fundosën, dhe në vitin 1999, me ardhjen në pushtet të Vladimir Putinit, rryma anti-

perëndimore e Ruisë rimori rrjedhën e vet.

Revolucioni Kinez i vitit 1949

Një tjetër pretendent i fortë për “revolucionin më të rëndësishëm politik” është Revolucioni Kinez i vitit 1949, në të cilin Partia Komuniste Kineze e udhëhequr nga Mao Ce Duni mundi nacionalistët kinezë dhe u bë organi i vetëm qeverisës i vendit. Kryengritja bolshevike mund të ketë pasur rëndësinë më të madhe gjatë shekullit të kaluar, por Revolucioni Kinez është më i rëndësishëm për ne sot.

Ashtu si Revolucioni i Tetorit, Revolucioni Kinez i vitit 1949 përfshiu një stuhi kulturore që u përhap në pjesë të ndryshme të botës. Mao besonte gjithashtu në pashmangshmërinë historike të një kryengritjeje globale socialiste, dhe megjithëse Republika Popullore e Kinës luajti një rol më pak të spikatur në konfliktet e huaja sesa Bashkimi Sovjetik, industrializimi i saj i shpejtë dhe transformimi kulturor frymëzoi lëvizje të shumta. Nga viti 1966 deri në 1967, revista Peking Review – buletini i vetëm kombëtar anglisht i Kinës – nxirmin në pah komunitete të ndryshme ndërkombëtare që kishin marrë përsipër organizimin e jetës së tyre private dhe praktikave të biznesit, sipas linjave maoiste. Këta përfshinin tregtarë nga Sri Lanka, zejtarë malianë, okulistë argjentinas, botues italianë, kërcimtarë nga Guineja, gazetarë

sirianë, ushtarë kongolezë dhe piratë venezuelas.

Megjithëse Peking Review e mbivlerësonte ndikimin dhe admirimin e Maos jashtë vendit, këto raporte tregojnë qartë se revolucionet e Kinës gjetën jehonë tek radikalët në vende të tjera. Sipas Julia Lovell, profesoreshë e historisë dhe letërsisë moderne kineze në Birkbeck, Universiteti i Londrës, “Mao dhe idetë e tij për revolucionin e vazhdueshëm fshatar u bënë thirrje rebelëve të krahut të majtë, si dhe aktivistëve të të drejtave civile dhe antiracizmit në SHBA, Australi dhe Evropën Perëndimore.”

Në Evropë, Revolucioni Kulturor frymëzoi protestat e studentëve, si dhe aktivizimin për të drejtat e feminstëve dhe homoseksualëve. Ndërkohë, shumë vende në zhvillim në Azi, Afrikë dhe Amerikën e Jugut morën shprehjet maoiste të “mbështetjes te vetja, korrigjimit të partisë dhe spontanitetit revolucionar” dhe i përfshinë këto në fushatat e tyre antikoloniale.

Komunizmi dhe statusi i Kinës si superfuqi

Revolucioni Kinez i vitit 1949 ishte veçanërisht i rëndësishëm, për aqsa lidhet me ngritjen e Republikës Popullore të Kinës si një superfuqi globale dhe – ndryshe nga Bashkimi Sovjetik – e qëndrueshme. Përpara se Partia Komuniste të merrte pushtetin, pozicioni i Kinës në skenën botërore ishte tepër i

komprometuar. Me të kaluarën e vet perandorake jo më shumë se një kujtim të largët, vendi vuajti shumë gjatë Luftërave të Opiumit, të cilat, përveç problemeve të përhapura shëndetësore, bënë që Kina të humbiste qytetin port të Hong Kongut.

Politika ekonomike kineze ishte e ndryshme nga ajo e vendeve të tjera. Duke ndjekur hapat e Bashkimit Sovjetik, Partia Komuniste Kineze prezantoi një ekonomi të planifikuar dhe centralizuar. Fermat private u riorganizuan në ato kolektive. Inputet dhe outputet industriale rregulloheshin, jo nëpërmjet forcave të tregut të lirë, por nëpërmjet planeve pesëvjeçare që përcaktonte qëllimet ekonomike afatgjata dhe shpërndarjen e burimeve.

Konsensusi midis studiuesve perëndimorë është se këto politika shpesh rezultojnë në katastrofë. Në vitin 1959, keqmenaxhimi, eksperimentet dhe fatkeqësitë natyrore krijuan një zi buke që solli vdekjen e rreth 30 milionë njerëzve dhe ngecja e zhvillimit industrial i shtyu kuadrot të vinin në dyshim aftësinë e Maos për të sunduar vendin. Të dhënat nga qeveria kineze gjatë kësaj kohe e ekzagjeruan shumë performancën ekonomike dhe pas vitit 1960, raportet statistikore pushuan së publikuari.

Zhvillimi ekonomik që e ktheu Kinën në një superfuqi nuk u zhvillua nën administrimin e Maos, por atë të pasardhësit të tij, Ten Hsiaopin. Në vitin 1978, Deng

propozoi një sërë reformash që e bënë më të lehtë për Kinën të bënte biznes me vendet e huaja. Pasi Kina kishte hyrë në tregtinë ndërkombëtare dhe flukset e investimeve, ekonomia e saj shpërtheu. Nga viti 1989 deri në 2017, PBB-ja e saj u rrit me një mesatare prej 9.71% në vit – zgjerimi më i shpejtë i qëndrueshëm në histori, sipas Bankës Botërore.


Fillimisht, studiuesit ia atribuuan suksesin e Ten Hsiaopinit, largimit të tij prej Maos: një triumf vendimtar i pragmatizmit mbi idealizmin revolucionar. Kohët e fundit, megjithatë, studiuesit filluan të rishqyrtojnë ndikimin e Maos në zhvillimin e Kinës. Sebastian Heilmann, president i Institutit të Studimeve Kineze dhe autor i “Sistemi Politik i Kinës”, ia atribuon lulëzimin gjeopolitik të vendit, gatishmërisë së tij për të eksperimentuar dhe marrë rreziqe – një strategji që e ka originën në qeverinë para-revolucionare të Maos.

“Si ndodhi që një sistem burokratik socialist ta merrte këtë aftësi përshtatëse, e cila nuk u pa në Evropën Qendrore?” thotë Heilmann, gjatë një interviste të vitit 2017 për “New York Times”. “Kjo ndodhi për shkak të përvojave historike specifike të kësaj partie... Ajo kontrollonte rajone shumë të përhapura dhe të distancuara. Pra, kur u provua diçka si reforma e tokës, u bë eksperimentalisht dhe në një mënyrë të decentralizuar. Kjo ishte thelbësisht e ndryshme nga Bashkimi Sovjetik”.

Big Think – Bota.al



Pelasgologët, humbologët, torolingologët



Nga: Sadik BEJKO

Nga dita që një petition nga gjuhëtarët tanë akademikë ka dashur t'i vërë një ledh turbogjuhëtarëve, pelasgologëve, ka ndodhur ajo dukuria e hedhjes së gurit në një pellg që trufullon i turbullt sa më nuk ka.

Të duket se janë rreshtuar dy taborë. Njëri që mbron gjuhën dhe tjetri që me kazmën e tij të profanit e profanon gjuhën. Kjo disi nuk qëndron. Na kanë përjashtuar nga fusha ne letrarët. Sipas një pikëpamjeje, ne shkrimtarët e bëjmë gjuhën, ne e gatujmë në magjen e gjallë materien e gjuhës. Shkencëtarët e gjuhës vijnë pas nesh. Si kosëtari që vjen pas të korrash.

Ç'është e vërteta, si punëtor në lëmë të gjuhës së lëvruar në letrat shqipe, unë i quaj turbogjuhologët a pseudot a pelasgologët kërpudha helmuese mbirë në trung të gjuhës, në këtë trung me rrënjë të rilindasit, te ata burrat që i kënduan me vargjet më të bukura gjuhës shqipe. Edhe sot i adhuroj e i them përmendësh vargjet e atyre burrave të themelit të kombësisë sonë si ideologji e filozofi kombëtariste. Ata nuk qenë shkencëtarë dhe rrënjët e gjuhës i gjetën në mitologji.

Po kështu nuk vazhdohej.

Ideologjia është veçan nga shkenca.

Me kohë erdhën shkencëtarë si Gustav Majeri (1850-1900) dhe të tjerë të huaj si ai, të cilët me argumente e mjete të ftohta të njeriut të shkencës, por dhe me ndjeshmëri të njeriut të një kombësie e shteti tjetër, pra, të neutralitetit si nacionalitet, provuan shkencërisht, jo me mitologji, me "gjuhësi" që shqipja është gjuhë indoeuropiane, që shqipja është gjuhë me prejardhje nga ilirishtja etj.

Prof. Xhevat Lloshi me mjetet e tij financiare ka shkruar atje ku ka jetuar Gustav Majeri (Grac, Austri) ku ka kërkua varrin e tij, dorëshkrimet e tij ... por, këtij burri që nuk na njihete, që nuk pa ku ishim e kush ishim, burrë që nuk u financua prej nesh për studimet që bëri, që i bëri në një kohë kur as shteti shqiptar nuk ekzistonte në ndonjë hartë të botës, këtij Majeri që edhe nuk fitoi ndonjë grosh për studimet mbi gjuhën e shqiptarëve ... në ditët tona nuk ia gjen as varrin mbi tokën ku jetoi, nuk i gjen as dorëshkrime në ndonjë arkiv.

Pelasgologët e sotëm me orientim të fortë nationalist nuk kanë treguar kurrfarë shpirti aq të fortë e të paanshëm profesionalisht sa ky Gustav Majeri që me librat shkrimet e tij në buletinet shkencore më prestigjioze, na bëri

të njohur shkencërisht, ndërkombëtarisht, pa na njohur e pa e ditur se cilët jemi.

Ndërkohë, këta pelasgologët, pseudot, turbogjuhologët tanë janë më të lavdishmit në mediat tona postmoderne. Në asnjë konferencë a buletin shkencor me prestigj ndërkombëtar (siç bëri Gutav Majeri) nuk i njeh njeri.

Si letrar, flas për studime postmoderniste ... Studime postmoderniste në shkencë? Kjo mund të jetë ndonjë dukuri tjetërsoj e shkencës gjuhësore shqiptare. Nuk flas për ndonjë veper letrare, si roman a dramë a poemë qoftë, nuk po flas për një veper fikson të një drejtimi postmodernist. Po flas për postmodernizëm si dukuri shkencore, shfaqje krejt të panjohur në ndonjë fushë të shkencave botërore. Postmodernizëm në gjuhësi? Ky është një hyner, një gjasë e pandodhur kurrë në ndonjë truall shkencërisht të gjallë në botë, kjo është veç një shpikje e shëmtuar e "shkencave" tona jo shkencore, apo një trill fare i marrë i fiksonit tonë shkencor në albanologjinë e zuzar-amatorëve.

Thashë që Gustav Majeri bëri shkencën e tij në një kohë kur nuk kishim as media, nuk kishim asnjë vend në hartën e botës dhe nuk pyeti se e pranon, se e dëgjon apo se nuk e dëgjon njeri ndër

pelasgologët. Ai vdiq, i humbi dhe varri ... Por, mirë a keq, edhe sot mbeti, edhe sot i përmendet vepra e tij.

Turboalbanologët e sotëm nguten, duan të jenë asa, të imponueshëm qoftë dhe dhunshëm në tregun e sotëm mediatik. Arrogantë, të urrejtshëm si ikonoklastët, ata thyejnë e shkelin ikonat klasike të albanologjisë tonë. Pa arritur shkencërisht as te thonjtë e këmbëve të tyre.

Gustav Majeri shkroi dhe heshti. Turbologët, pelasgologët tanë duan të jenë të adhureshëm me zor, u drejtohen mediave për t'u afirmuar. Ngatërrojnë me dashje mejdanin ku duhet të përballohen. Nuk kishte media elektronike në kohën e Majerit. Ishin katedrat e universiteteve që verifikonin arritjet shkencore të dijetarëve. Edhe sot janë katedrat universitare, edhe sot janë konferencat shkencore forumet që i shkojnë në sitë të hollë prurjet shkencore. Në këto katedra u afirmua fillimisht dhe Anjshtajni, Darvini etj. Katedrat universitare janë vendet ku turbogjuhologët tanë nuk zbarkojnë dot. Shumica e tyre janë grafologë pa pikë kredie. Njerëz pa asnjë kredi si gjuhëtarë të profesionit, pa asnjë dijeni mbi gjuhët e huaja të sotme a mbi gjuhët klasike greko-romake. Nëse nuk pëlqejnë forumet

shkencore shqiptare, pse nuk u drejtohen tryezave shkencore ndërkombëtare? Kush i pengon?

Si letrar jam i bindur se gjuhën e krijojnë shkrimtarët, poetët ... jo turbo-budallët, pelasgologët. Jam me letrarët, prozatorët, poetët, fjalëbukurit, estetët, eseistet, analistët, mjeshtrat e tekstit të shkruar të kësaj gjuhe. Turbopelasgologët si kërpudhat kanceroze peshojnë në trung, në rrënjë, në fletë të gjuhës shqipe ... shpërthejnë si shtëllungat helmuese të Hiroshimës. Shumica e pelasgologëve nuk e kanë profesion gjuhësinë. Le të kthehen në shkencat e tyre. Në këtë lëmë që nuk është i tyre janë, e pakta të themi, sharlatanë të diskredituar. Pa asnjë të ardhme. Pa dafina. Pa truall.

Dy nga mjeshtrat e shkrimit shqip, Konica dhe Noli, ishin edhe shkencëtarë. Po ata e shkruan bukur shqipen pa kërkuar nëse fjala shqipe ka rrënjë a ka hambar ndër pelasgë a ... le të themi, në Alaskë.

Pelasgologët janë emër-vdekur ... qëkur kanë zgjedhur të hyjnë të verbër në trojet e Konicës, të Nolit, të Naimit, Poradecit, Kutelit, Koliqit, Fishtës, Mjedës ... Këta burra e shkruanin shqipen shqip pa pyetur ç'do të thonë pelasgologët, humbologët, torolingologët ...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ndeshje interesante në elitën e basketbollit



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**
PRISHTINË, 1 MARS - Superliga e basketbollit rikthehet në aksion me ndeshje shumë interesante pas ndeshjeve që zhvilloi Përfaqësuesja e Kosovës në kuadër të Rrethit e Parë Parakualifikues për FIBA Kupën e Botës 2027. Rivalet nga Rrafshi i Dukagjinit, Vëllaznimi dhe Peja, e hapin javën e 22-të në Prince Caffè Superligë, që është pjesa finale e kampionatit. Ndeshja që do të zhvillohet në Gjakovë pritet të jetë shumë interesante dhe atmosfera e jashtëzakonshme. Kuqezinjtë janë në vendin e pestë me nëntë fitore e 12

humbje, kurse verdhezinjtë ndodhen në vendin e dytë me 15 fitore dhe gjashtë humbje. Të shtunën në program është edhe ndeshja tjetër e rëndësishme në mes të Bashkimit dhe Golden Eagle Yllit. Prizrenasit janë në vendin e gjashtë me tetë fitore dhe 13 humbje, kurse therandasit në pozitën e katërt me 12 fitore dhe nëntë humbje. Të dielën liderja Trepça e pret Istogun, ku mitrovicasit shihen favoritë. "Xehetarët" ndodhen në vendin e parë me 19 fitore e dy humbje, kurse istogasit në vendin e fundit me një fitore e 20 humbje. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje zhvillohet mes Proton Cable Prizrenit dhe Sigal Prishtinës, ku

fitorja është shumë e nevojshme për të dyja skuadrat. Skuadra prizrenase renditet në vendin e shtatë me gjashtë fitore e 15 humbje, kurse ajo prishtinase në pozitën e tretë me 14 fitore dhe shtatë humbje.

SUPERLIGA - Java 22

Të shtunën takohen:
17:00 Vëllaznimi - Peja
19:00 Bashkimi - Golden Eagle

Të dielën takohen:
17:00 Trepça - Istogu
19:00 Proton Cable Prizreni - Sigal Prishtina

SHKURT

Më 5 dhe 6 mars mbahet turneu 'Adem Jashari' në futsall

Në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet Komisionit për Futsall, në bashkëpunim me komunën e Skenderajt, do ta organizojë turneun tradicional "Adem Jashari". Ky është edicioni i 15-të me radhë. Edhe sivjet turneu mbahet në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj, me pjesëmarrjen e katër ekipeve të Superligës dhe fillon më 5 mars, me ndeshjet gjysmëfinale ndërmjet FC Drenica - FC Liqeni, orën 18:00, dhe FC Mabetex Prishtina - FC Vjosa, në orën 20:00. Ndërkaq ndeshja finale zhvillohet të mërkurën më 6 mars, në orën 20:00, teksa para ndeshjes finale luhet ndeshja revyale Veteranët e Kosovës - Veteranët e Drenicës.

Kosova bie për dy pozita në renditje të FIBA-s

Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka rënë për dy pozita në FIBA. Në ranglistën e re që ka publikuar FIBA të premtën, Dardanët renditen në vendin e 79-të nga pozita e 77-të, në të cilën ishin më parë. Kosova luajti dy ndeshje gjatë muajit shkurt, të parën e fitoi në Prishtinë ndaj Irlandës, ndërsa në tjetrën pësoi humbje në udhëtim tek Azerbajxhani. Ndërkohë, në vendin e parë në renditje vazhdon të mbetet ShBA-ja, teksa në pozitën e dytë Spanja dhe në të tretën Gjermania.

Kuka: Programi 'Kosova shteti i xhudos' po jep frytet e tij

Trajneri Driton Kuka ka thënë se programi "Kosova shteti i xhudos" po jep frytet e tij. Kuka kështu ka shkruar në rrjetin e tij social në "Facebook", duke thënë se janë duke u stërvitur në Golem të Shqipërisë me disa mysafirë të huaj. Ai tregoi se tanimë Kosova po merr pjesë me 45 garues në gara ndërkombëtare dhe, siç tha Kuka, të gjithë janë me nivel serioz. "Kampi stërvitor Kosovë - Shqipëri me disa mysafirë të huaj po shkon mirë!", ka shkruar Kuka. "Sezoni e garave në vllugun e saj në krejt grupmoshat. Tashmë Kosova po garon me afër 45 garues në gara ndërkombëtare dhe të gjithë me nivel serioz. Projekti 'Kosova shteti i xhudos' po jep frytet e saj me masivitet gjithandej në klube, seksione e shkolla të xhudos!", ka shtuar Kuka.

Tri ndeshje sot, dy nesër në Superligën e futbollit

Prishtinë, 1 mars - Tri ndeshje të javës së 23-të në Superligën e futbollit do të zhvillohen sot (e shtunë) dhe dy të tjera nesër (e diel). Kampioni në fuqi dhe lideri aktual, Ballkani, ka përpara vetes një sfidë mjaft të

vështirë, ku e pret Dukagjini në Klinë. Suharekasit po kalojnë nëpër një formë jo të mirë dhe nëse dështojnë edhe ndaj Dukagjinit mund ta humbasin pozitën e parë në tabelë. Në krahun tjetër, klinasit kërkojnë të mbeten

në garë për pozitën e pestë, pasi momentalisht janë të gjashtë dhe vetëm një pikë e ndan nga synimi. Në ndeshjen tjetër, Llapi i shkon Feronikelit 74. Llapjanët nuk fituan në xhiron e fundit dhe tash

kërkojnë tri pikët ndaj një kundërshtari aspak të lehtë. Skuadra e tretë në tabelë, Drita, i shkon Fushë-Kosovës. Të dielën Prishtina e pret Lirinë, kurse Malisheva luan në udhëtim te Gjilani.



Fitore bindëse e Kosovës U18, sot synohet bileta e Botërorit

PRISHTINË, 1 MARS - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll ka fituar bindshëm në ndeshjen e dytë në IHF Trophy Intercontinental. Të premtën në mëngjes në Tashkent të

Uzbekistanit vashat e Kosovës fituan ndaj Guatemalës me rezultat 31:12. Cilësia ishte plotësisht në anën tonë dhe rezultati e dëshmon këtë. Si fituese e grupit, Kosova U18 avancon

në gjysmëfinale. Të shtunën Kosova përballet me Kaledoninë e Re. Me fitore sigurohet finalja dhe kualifikimi në Kampionatin Botëror që në verë mbahet në Kinë. Ndaj Guatemalës,

Arjeta Imeraj u shpall lojtare e ndeshjes. Ajo i realizoi 7 gola, sa i kishte edhe Andra Uglani. 6 gola i shënoi Arona Krasniqi. Kualifikimi në Botëror do të jetë sukses historik.



Superliga vazhdon me derbi të madh në Rahovec

RAHOVEC, 1 MARS - Në këtë fundjavë zhvillohen ndeshjet e xhiros së 18-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Sot (e shtunë) nga ora 15:00 Prishtina është favorite e madhe ndaj Deçanit, të dielën prej orës 19:00 tifozët e hendbollit i pret kryendeshja në mes të Rahovecit dhe Besa Famgasit. Ky superderbi zhvillohet në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec. Pritet ndeshje e fortë dhe dramatike deri në fund. Rahoveci është në seri impulsive prej 17 fitoreve. Udhëheq në tabelë me 34 pikë. Kampionia në fuqi, Besa Famgas, është e dyta me 28 pikë. Ka 14 fitore dhe tri humbje. Dy prej humbjeve ia ka shkaktuar Rahoveci. Por që të dyja ndeshjet ishin shumë të forta dhe u vendosën në aksionet e fundit. Në kuadër të xhiros së katërt, më 9 shtator, Rahoveci kishte fituar si



nikoqir me rezultatin 34:33. Në kuadër të xhiros së 11-të, më 26 nëntor, "vreshtarët" kishin fituar në Pejë me rezultat 29:27, ndonëse Besa ishte duke udhëhequr 15:13 pas

pjesës së parë. Rrjedha e dy ndeshjeve të kaluara garanton superderbi edhe të dielën mbrëma. Ndeshja në mes të Trepçës dhe Vëllaznimit është shtyrë.

Denveri fiton duelin me Miamin, lakersat buzëqeshin në shtesë

DENVER, 1 MARS - Denveri kampion fitoi me rezultat 103-97 ndaj Miamit, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në NBA. Porter me 30 pikë ishte lojtari i ndeshjes, duke i dhënë fitore skuadrës së Denverit. Pas kohës shtesë fitojnë lakersat, që e mposhtën Washingtonin (134-



131). Anthony Davis me 40 pikë si dhe LeBron Jamesi me 31 pikë bënë diferencën në fushë për vendasit, duke i bërë të pavlefshme 34 pikët e Pooles për miqtë. Fitoi edhe Milwaukee, që mundi me

rezultat 111-99 Charlotten, takim ku dallua Antetokounmpo me 24 pikë e 10 rebounde. Jashtë fushës fitoi edhe Golden State, që mundi 110-99 New Yorkun. Për Warriorsin u dallua Stephen Curry me 31 pikë.

REZULTATET

Charlotte - Milwaukee	99-111
Orlando - Utah Jazz	115-107
Brooklyn - Atlanta	124-97
New York - Golden State	99-110
San Antonio - Oklahoma	132-118
Phoenix - Houston	110-105
Denver - Miami	103-97
Lakers - Washington	134-131

U pezullua nga futbolli, reagon Pogba: Jam i zhgënjyer, do ta apeloj vendimin

Mesfushori i Juventusit, Paul Pogba, ka publikuar një mesazh të gjatë në rrjetet sociale pas vendimit të Gjykatës Kombëtare Anti-Doping për ta shkualifikuar nga futbolli për katër vjet. "Sot u njoftova për vendimin e Gjykatës Kombëtare Antidoping dhe besoj se dënimi është i gabuar. Jam i trishtuar, i tronditur dhe i zemëruar. Gjithçka që kam ndërtuar në karrierën time si lojtar profesionist, hidhet poshtë. Kur të jem i lirë nga kufizimet ligjore, e gjithë historia do të jetë e qartë, por unë kurrë nuk kam marrë me vetëdije apo qëllimisht suplemente që shkelin rregulloren anti-doping. Si një sportist profesionist nuk do të bëja kurrë asgjë për ta përmirësuar



performancën time duke përdorur substanca të ndaluara dhe nuk kam mashtruar kurrë sportistët e tjerë dhe tifozët e ndonjë skuadre kur

kam luajtur për ta ose kundër. Si rezultat i vendimit të shpallur sot, do të apeloj në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv", është shprehur Pogba.

SHKURT

Abrashi rinovon me Grasshoppersin

Mesfushori shqiptar Amir Abrashi ka rinovuar kontratën me skuadrën zvicerane Grasshoppers. Abrashi dhe klubi në fjalë do të vazhdojnë së bashku deri në vitin 2025. Kapiteni i klubit zviceran, pasi firmosi kontratën e re, u shpreh tepër i lumtur. "Për mua nuk ka asnjë klub tjetër përveç Grasshoppers. Kam mësuar, përjetuar dhe zhvilluar shumë këtu. Këtu jam si në shtëpi. Jam i lumtur që mund të vazhdoj në këtë klub dhe dua ta arrij potencialin tim të plotë", u shpreh Abrashi.

Daku vendos rekord të veçantë në Rusi

Mirlind Daku është kthyer në një nga lojtarët më të rëndësishëm të Rubin Kazanit. Sulmuesi kuqezi u transferua gjatë verës te skuadra ruse dhe është titullar i padiskutueshëm. Lojtari i lindur në Gjilan ka shënuar 4 gola dhe ka dhënë një asistim. Megjithatë, Daku, krahas golave, jep kontribut të jashtëzakonshëm në repartin e avancuar. Diçka e tillë konfirmohet nga fakti se Daku është futbollisti me më shumë duele të fituara në kampionatin rus. 26-vjeçari ka arritur të fitojë 136 duele në 16 ndeshjet e zhvilluara, duke qenë rekordmen absolut në këtë drejtim. Daku është një rrezik konstant në zonën kundërshtare për çdo ndeshje. Sulmuesi do të synojë ta arrijë formën më të mirë deri në maj, në mënyrë që të jetë pjesë e listës së Sylvinhos për Kampionatin Evropian që do të luhet në Gjermani verën e ardhshme.

Joshua provokon Ngannou: Atë që nuk e bëri Fury do ta realizoj unë

Më 8 mars në Ryad të Arabisë Saudite do të zhvillohet dueli i peshës së rëndë në boks mes boksierit britanik Anthony Joshua dhe kamerunasit Francis Ngannou. Ky i fundit, ish-kampion në artet marcialle mikse, ka lënë kafazin për ringun. Ngannou debutoi disa muaj më parë në ring, në një duel të humbur ndaj Tyson Furyt, por tashmë do ta synojë fitoren e parë ndaj një tjetër britaniku. Gjithsesi, Joshua nuk është i "gatshëm ta hapë krahun", madje kërkon t'i japë një leksion të mirë Ngannou. Joshua, ish-kampion bote në peshën e rëndë, vjen nga një seri prej 3 fitoresh radhazi, duke mos humbur që prej vitit 2022. "Unë e përgëzoj Francis për duelin ndaj Furyt, bën një luftë argëtuese, por kjo është në të kaluarën. Kështu është boksi dhe ne ecim përpara tani", ka deklaruar Joshua. "Jam përgatitur mirë dhe jam gati të boksoj ndaj tij, do t'i tregoj se si është boksi i vërtetë. Mund të jetë një trupmadh, por unë jam një boksier që e njuh ringun më mirë dhe do t'i tregoj se sa vlej. Atë që nuk e bëri Fury do ta realizoj unë. Kjo është thjesht një ndeshje boksi", ka pohuar Joshua.

UEFA dënon Bayernin dhe Marseillen për shkak të tifozëve

Komiteti i Kontrollit, Etikës dhe Disiplinës i UEFA-s ka qenë shumë i ashpër në vendimet e fundit për Bayern Munichun dhe Marseillen. Në rastin e gjermanëve, në ndeshjen ndaj Lazios në Romë më 14 shkurt, pati ndezje flakadanësh, hedhje sendesh nga tifozët në fushë dhe një karton i kuq për Upamecano. UEFA ka vendosur ta dënojë klubin "bavarez", duke e ndaluar t'u shesë bileta tifozëve për ndeshjen e ardhshme që do të luajë në transfertë në kompeticionet e UEFA-s. Bayerni ka marrë edhe një gjumë prej 10 mijë eurosh për sendet në fushë dhe 40 mijë euro për ndezjen e mjeteve piroteknike. Nga ana tjetër, Marseille është gjobitur për ngjarjet pas ndeshjes së parë kundër Shakhtar Donetskut më 15 shkurt. UEFA gjobiti francezët me 50 mijë euro dhe ndalimin e shitjes së biletave për tifozët e saj për ndeshjen e ardhshme në transfertë në kompeticionet e UEFA-s.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
